



DIALOG

FËMIJËT NË TIRANË
RAPORT VJETOR 2016



HYRJE

Linja e Këshillimit për Fëmijë (ALO 116 111) është një shërbim që ka për qëllim të ndihmojë fëmijët përmes këshillimit me telefon dhe referimit në Institucionet qeveritare dhe joqeveritare që ofrojnë shërbime për fëmijët. Lançimi zyrtar i ALO 116 – Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë është bërë më 1 Qershor 2009 gjatë një Konference Kombëtare me titull *“Unë jam fëmijë dhe kërkoj mbështetjen tuaj për të respektuar të drejtat të mia”*, organizuar nga qeveria Shqiptare dhe Zyra UNICEF- Shqipëri. Kjo konference hapi një rrugë të re në marrëdhëniet e fëmijëve me shërbimet e mbrojtjes dhe përkujdesit social në Shqipëri, falë mbështetjes së jashtëzakonshme të UNICEF-Shqipëri dhe CRCA si dhe kompanitë e telefonisë së lëvizshme: Telekom, Vodafone, ALBtetelcom, Egel mobile, Plus etj.

ALO 116 - ANCH funksionon si shërbim unik për këshillimin e fëmijëve, ofron shërbim 24 orë në 7 ditë të javës dhe është në dispozicion të të gjithë fëmijëve në Shqipëri. Fëmijët dhe prindërit mund të marrin informacion si dhe të raportojnë në rastet e fëmijëve të humbur, në rast të dhunës dhe keqtrajtimit të fëmijëve ku ai/ajo bën pjesë në familje, në shkollë ose komunitet etj. Çdo fëmijë ka akses falas për shërbimet e Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë. ALO 116 ka si qëllim të sjellë përmirësime të qëndrueshme në jetën e fëmijëve në Shqipëri. Me këtë vizion Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë – ALO 116 është e angazhuar për të mbështetur, ndihmuar, informuar dhe orientuar nevojat e fëmijëve në shërbimet ekzistuese të sistemit të mbrojtjes të fëmijëve në vend.

ALO 116 111 është krejtësisht e përkushtuar për nxitjen e një bashkëpunimi më të madh mes aktorëve vendorë, rajonalë, dhe ndërkombëtarë që punojnë për fëmijët. Parimi kryesor i punës sonë të përditshme është respekti, pjesmarrja dhe mirëqënia e fëmijëve, ruajtja e konfidencialitetit dhe ndërgjegjësimi publik për të drejtat e tyre. Për rrjedhojë ne punojmë për të inkurajuar fëmijët që të flasin në çështje që prekin të drejtat dhe interesat e tyre. Falë këtij shërbimi, fëmijët mund të ushtrojnë disa të drejta shumë të rëndësishme për ta: të drejtën për tu dëgjuar, për të marrë pjesë, për të informuar, për të qenë të mbrojtur nga dhuna dhe shfrytëzimi etj.

Ne sot jemi krenarë që gjatë 7 viteve të punës sonë, kanë marrë përgjigje më shumë se 583.408 telefonatave të fëmijëve, prej të cilave, janë trajtuar 14.196 raste nga e gjithë Shqipëria. Linja Kombëtare e Ndhmës ALO 116 ka krijuar një eksperience dhe praktikë pozitive në forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke bashkëpunuar me institucione dhe organizata partnere në lidhje me çështjet që afektojnë direkt mirëqenien e fëmijëve në Shqipëri.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga sistemi i “call centre” (qendra e thirrjeve) dhe rastet e regjisturara, është përgatitur klasifikimi i të dhënave cilësore dhe sasiore të telefonatave që vijnë në ALO 116. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 numri total i telefonatave raportohet **27.389** telefonata. Ndërkohë, duhet thënë se një pjesë e konsiderueshme e telefonatave rregjistrohen nga fëmijë/adoleshentë apo të rritur të cilët raportojnë se në momentin e telefonatës ndodhen në Tiranë.

Numërohën për vitin 2016 rreth **3400** telefonata nga kryeqyteti . Tirana është qyteti që ka numrin më të lartë të telefonatave dhe të rasteve të trajtuara gjithashtu. Rastet më të shumta të raportuara nga këta fëmijë lidhen me problematika të marrdhënieve ndërpersonale, familjare, abuzime dhe dhunë dhe raportime te rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve për arsye përfitimi. Prandaj, ky raport ka për qëllim të informojë të gjithë të intersuarit mbi të dhënat e raportuara pranë ALO 116 111 gjatë vitit 2016 vetëm për qytetin e Tiranës. Më gjerësisht ne duam të ndajmë me ju, raportin e punës sonë gjatë viti 2016, për t’ju prezantuar edhe se cilat janë nevojat dhe shqetësimet që fëmijët raportojnë pranë Linjës Kombëtare të Telefonit për Fëmijët në Shqipëri.

Ju faleminderit !

ALO 116

Misioni i ALO 116 111

ALO 116 111- Linja Kombëtare e Telefonit të Ndhmës për Fëmijët është një shërbim publik kombëtar këshillimi dhe referimi për fëmijët në Shqipëri. Ajo komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116 – Linja e Ndhmës për Fëmijët në Shqipëri; 116-000 Linja e Telefonit për Fëmijët e Humbur dhe 116-111 Linja Pan-Europiane e Telefonit për Fëmijët.

ALO 116 flet me fëmijët në momentet më të vështira të jetës së tyre. Ne punojmë që të mbrojmë mirëqenien e fëmijës, nëpërmjet këshillimit me telefon, referimit dhe mbrojtjes pro-aktive të të drejtave të fëmijëve. Parimet kryesore të punës sonë janë:

- ✚ Ne i përgjigjemi falas çdo telefonate të fëmijëve, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës
- ✚ Ne këshillojmë dhe informojmë fëmijët për çdo problem që ata kanë;
- ✚ Ne referojmë çdo rast, që kërkon zgjidhje, pranë shërbimeve publike dhe private të mbrojtjes së fëmijës;
- ✚ Ne luftojmë për të garantuar në punën tonë standardet më të larta dhe më profesionale të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë;
- ✚ Ne besojmë se çdo fëmijë dhe i ri, pavarësisht moshës apo aftësisë, gëzon të drejta të barabarta dhe ai është i aftë të identifikojë dhe shprehet për problemet që e shqetësojnë;
- ✚ Ne punojmë që të bëjmë të mundur pjesmarrjen e fëmijëve;
- ✚ Ne jemi në dispozicion edhe të fëmijëve që nuk kanë telefon, nëpërmjet postës dhe komunikimit me e-mail.

Objektivat e ALO 116 111

- ✚ Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes së Fëmijëve nëpërmjet avokatësisë dhe mbështetjes së një sistemi efektiv për fëmijët që kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje;
- ✚ Marrja në konsideratë e zërit të vetë fëmijëve nëpërmjet ndërgjegjësimit të gjithë partnerëve sociale;
- ✚ Lehtësimi i fëmijëve në nevojë dhe përgjigjia ndaj nevojave të tyre, duke vënë në funksionim shërbime të koordinuara.


Shërbimet e ALO 116 111

- ✚ Informimi i fëmijëve, të rinjve, prindërve apo personave të tjerë që punojnë për fëmijët, rreth shërbimeve që ofron linja;
- ✚ Psiko-edukim mbi tematika të tilla si duhani, droga, sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe karakteristikave që ndjekin fazat e zhvillimit psiko-social dhe fizik tek fëmijët;
- ✚ Trajtim dhe ndërhyrje e menjëhershme për fëmijët në rrezik;
- ✚ Mbështetje emocionale për fëmijët dhe adoleshentët në gjendje krize;
- ✚ Bashkëpunim me institucione shtetërore dhe organizata private për të mundësuar ofrimin e ndihmës së nevojshme fëmijëve dhe familjeve;
- ✚ Ofrimi i këshillimit profesional me telefon dhe referimi i rasteve në shërbimet sociale që operojnë në Shqipëri, sipas nevojave të fëmijëve;

ANALIZA E TË DHËNAVE VJETORE PËR FËMIJËT NË TIRANË

Raporti Vjetor 2016 për fëmijët në Tiranë, është një pasqyrim i të dhënave që janë produkt i mbledhjes së telefonatave të pritura në një periudhë 12 mujore dhe të specifikuar vetëm për qytetin e Tiranës. Më poshtë do të paraqiten në mënyrë më të detajuar të dhënat që janë mbledhur në bazë të raportimeve që janë bërë pranë ALO 116 nga fëmijë dhe të rritur që kanë telefonuar nga Tirana. Numri i përgjithshëm i telefonatave të pritura në Linjën Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë për këtë periudhë nga fëmijë/adoleshentë/ të rritur nga Tirana është 3400 telefonata. Pjesa më e madhe e tyre janë fëmijë, rreth 93% e telefonatave. Vetëm 7 % e telefonuesve nga Tirana janë të rritur. Grupmosha që ka telefonuar më shpesh është 13-15 vjeç. Vihet re se telefonuesit nga kryeqyteti më të shumtë në numër janë meshkujt.


Grafiku 1: Fëmijë kundrejt të rritur



Grafiku paraqet raportin e telefonatave të realizuara nga fëmijë-të rritur- të panjohur për vitin 2016


- ✓ 3170 thirrje nga telefonues fëmijë
- ✓ 230 thirrje nga telefonues të rritur (prindër, të afërm dhe të njohur të fëmijëve, mësues dhe profesionistë që punojnë me dhe për fëmijët.

Grafiku 2: Klasifikimi Gjinor



Grafiku 2 tregon përqindjen e shpërndarjes së telefonatave sipas gjinisë së telefonuesve nga Tirana për vitin 2016. Sipas grafikut raportohen 2015 telefonata nga djemtë që përbën 59% të totalit të telefonatave. Ndërsa vajzat përbëjnë 41% të telefonatave totale ose 1385 telefonata. Pra ajo që identifikohet edhe për këtë vit është një tendencë që numri i telefonatave nga fëmijë/ të rritur djem është më i lartë krahasuar me telefonueset vajza.

Grafiku 3 : Klasifikimi i telefonatave mbi bazë grupmoshës së telefonuesve




Grupmosha e fëmijëve nga Tirana që kanë telefonuar më shpesh për vitin 2016 pranë ALO 116 janë fëmijët e grupmoshës 13-15 vjeç dhe shumica janë fëmijë të gjinisë mashkullore. Po ashtu të shumta kanë qënë telefonatat nga grupmosha 10-12 vjeç, ku përsëri dominojnë fëmijët të gjinisë meshkuj. Raporti femra-meshkuj është lehtësisht i balancuar në grupmoshën 7-9 vjeç. Ndërkohë vajzat përbëjnë shumicën vetëm në kategorinë 0-6 vjeç. Kjo përbën edhe kategorinë e grupmoshave që telefonon më pak, e kuptueshme kjo duke u bazuar në moshën e tyre.

Grafiku : 4 Klasifikimi i telefonatave sipas prurjes se tyre


Në Alo 116 telefonatat kategorizohen në bazë të shpeshtësisë që një telefonues ka telefonuar.

- ✓ Permanente - Në telefonatat permanente grupohen ato biseda, të cilat vijnë nga telefonues, që marrin më tepër se një herë në ditë pranë Linjës së Këshillimit për Fëmijët;
- ✓ Periodike - Në telefonatat periodike klasifikohen bisedat që kanë telefonuar më tepër se një herë dhe të cilat kanë hyrë procesin e trajtimit;
- ✓ telefonata të reja - klasifikohen ata të cilët telefonojnë për herë të parë tek ALO 116;
- ✓ Telefonata të pa identifikuar, të cilat zënë dhe numrin më të madh të telefonatave, ku përfshihen ato biseda të cilat këshilluesit nuk arrijnë të identifikojnë nëse telefonuesi e ka për herë të parë që telefonon në linjë



Nga Grafiku vihet re se viti 2016 ka rregjistruar një numër të lartë telefonuesish të rinj nga Tirana. Numri i lartë i telefonatave të reja vjen si pasojë edhe e fushatës ndërgjegjësuese që është realizuar në shkolla të ndryshme të Tiranës. Telefonuesit periodik dhe permanent tregojnë se fëmijë/adoleshentë të ndryshëm kanë kontaktuar në periudha të ndryshme disa herë Linjën e Këshillimit për Fëmijë.

Grafiku 5: Rezidenca e telefonuesve



Sipas raportimeve të muajve Janar- Dhjetor 2016 për qytetin e Tiranës, shumica e telefonuesve preferojnë të flasin me ALO 116 111 ndërkohë që janë vetëm. Telefonatat trajtuese, këshilluese apo referuese tregojnë se fëmijët janë më të lirshëm të flasin për problematikat e tyre ndërkohë që janë vetëm. Ndërkohë kur fëmijët ndodhen me shoqërinë, përgjithësisht janë telefonata testuese. Në lidhje me kategorinë e telefonuesve të rritur mund të themi se, ata telefonojnë në praninë e familjarëve dhe kryesisht kur janë vetëm pa shoqërinë e dikujt tjetër. Një pjesë e telefonuesve të rritur, të ndodhur në rrugë në momentin e telefonatës, kanë raportuar raste të fëmijëve në situatë rruge. Ndërkohë fëmijët të cilët ndodhen në shkollë përgjithësisht kanë telefonuar për t'u informuar mbi Linjën e Këshillimit për Fëmijë, shërbimet që ofron, këshilla mbi lundrimin e sigurt në internet, apo çështje të tjera që lidhen me të drejtat e tyre.

Grafiku 6: Klasifikimi i përgjithshëm i telefonatave

Gjatë vitit 2016 numri total i telefonatave nga Tirana që kanë marrë përgjigje nga këshilluesit është **3400** telefonata. Numri më i lartë i telefonatave është regjistruar në muajin Qershor dhe Dhjetor 2016. Numri më i lartë i trajtimeve dhe këshillimeve psikologjike regjistrohet në muajin Shkurt 2016 dhe tregon një produktivitet të lartë në përputhje numrin e telefonatave. Në kuadër të të dhënave të mbledhura është bërë klasifikimi cilësor dhe sasior i tyre, të dhëna që paraqiten përgjatë këtij raporti në vijim. Në këtë klasifikim përfshihen:


Telefonata për këshillim: Përfshihen telefonatat ku ofrohet këshillim psiko-social ndaj fëmijëve, adoleshentëve dhe në pak raste të rinjve të moshës 18-21 vjeç. Problematikat dhe shqetësimet e raportuara tek ALO 116 gjatë këtij viti kanë qënë të larmishme. Marrëdhëniet me partnerin/en, problemet afektive, marrëdhëniet familjare, dhuna dhe abuzimi, fenomeni i bulizmit, problemet me mësuesit, problemet akademike, lypja, varësia nga substancat, problemet në përdorimin e internetit etj, kanë qënë disa nga çështjet me të cilat janë përballur këshilluesit pranë ALO 116.

Telefonata për informacion dhe psikoedukim : Fëmijët telefonojnë shpesh për të kërkuar informacion mbi shërbimet e ALO 116, mbi statet e zhvillimit, karakteristikat, çështje të të drejtave të fëmijëve, çështje që lidhen me internetin, apo dëshirojnë të shprehin talentin dhe dëshirat e tyre, etj.

Telefonata të ndërprera : Ndodhin që për arsye teknike apo për arsye të fluksit të lartë të telefonatave të ketë ndërprerje të bisedës midis këshilluesit dhe fëmijës. Kjo ndërprerje mund të ndodhë si nga prania e papritur e një personi të rritur në momentin e bisedës midis fëmijës dhe ALO 116, ashtu edhe për shkaqe teknike.

Telefonata testuese:

Në kategorinë e telefonatave testuese përfshihen: telefonatat e heshtura (receptori është i hapur, por personi nuk flet); telefonata në mjedis të larta me zhurmë ose mjedis me muzikë të lartë; telefonata tallëse dhe ofenduese, apo edhe ato telefonata ku shprehet nivel i lartë agresiviteti. Pavarësisht kësaj çdo telefonatë është trajtuar në mënyrë serioze dhe profesionale nga stafi. Numri i telefonatave testuese ka qënë në rritje muajt e fundit.



Numri total i telefonatave nga Tirana për periudhën Janar- Dhjetor 2016 ka qënë **3400** telefonata.


Këto telefonata janë klasifikuar si më poshtë:

- ✓ 1174 telefonata për informacion
- ✓ 712 telefonata psikoedukuese
- ✓ 304 telefonata për këshillim
- ✓ 200 telefonata të ndërprera
- ✓ 1010 telefonata testuese

Siç shihet nga grafiku i mësipërm, pjesa më e madhe e telefonuesve nga Tirana kanë kërkuar informacion mbi shërbimet e ALO 116, çështje që kanë të bëjnë më të drejtat e fëmijëve, sigurisë në internet, kanë përshëndetur ose kanë marrë psikoedukim në varësi të problematikës që është trajtuar gjatë bisedës telefonike. Telefonatat testuese gjithashtu reflektojnë tentativat e para të fëmijëve të cilët përpa krijojnë besimit tek operatori këshillues zgjedhin ta testojnë atë në forma të ndryshme. Numërohen në total 1010 telefonata testuese.

Këshilluesit gjithashtu kanë marrë një numër të konsiderueshëm telefonatash nga fëmijët me të cilët kanë punuar për të ofruar këshillim psikologjik për problematikat që kanë raportuar.


Grafiku 7. Klasifikim i telefonatave informuese dhe për psiko-edukim



Çdo ditë ka telefonues të rinj që telefonojnë për tu informuar për shërbimet që ofron ALO 116. Fëmijët dhe adoleshentët shprehin dëshirën të informohen për çështje të fëmijëve/ të drejtat e fëmijëve, rëndësinë e aktiviteteve të tyre të përditshme, aktivitete që kanë ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre, falenderojnë për ndihmën që kanë marrë nga ALO 116 etj. Por fëmijët e kanë konsideruar ALO 116 si një “vend” në të cilin mund të ndajnë talentin e tyre në këndim dhe recetim. Këtë vit u shtua edhe kategoria e informacionit mbi çështje të internetit. Shifrat tregojnë se ka një interes relativisht të lartë nga ana e fëmijëve për t’u informuar mbi këtë temë .

Janë pritur gjithsej **1174** telefonata për informacion nga Tirana. Pjesa më e madhe e telefonuesve nga Tirana kanë kërkuar informacion mbi Linjën dhe janë informuar mbi shërbimet që ajo ofron. Numri i lartë i telefonatave informuese mbi linjën ka ardhur si rrjedhojë edhe e ndikimit që ka pasur fushata ndërgjegjësuëse e realizuar për një periudhë disa mujore në më shumë se 45 shkolla 9-vjeçare të kryeqytetit.

Grafiku 8. Problematikat e Raportuara për Bashkinë Tiranë



Siç mund të shihet nga grafiku, fëmijët përballen me një gamë të gjerë të çështjeve, shqetësimeve dhe problemeve. Një pjesë e këtyre shqetësimeve është e identifikuar nga ata dhe raportohet menjëherë tek këshilluesit, por në mjaft raste duhet ndihma e këshilluesve në identifikimin e problemeve reale. Në baze të të dhënave të analizuara për vitin 2016 dhe duke i krahasur këto të dhëna me raportuara ndër vite, rezulton se shqetësimet në lidhjet ndër-personale vazhdojnë të jenë në nivel të lartë. Marrëdhëniet me shokët, me partnerin/en si dhe problematikat me anëtarët e familjes, veçanërisht marrëdhënia prind-fëmijë janë temat më të trajtuara në këtë shërbim. Në nivele të konsiderueshme mbeten telefonatat për raportim të rasteve të abuzimit, neglizhimit dhe dhunës në familje, probleme në shkollë, me mësuesit, shqetësime të lidhura me shëndetin psiko social ose çështje të sigurisë online. Nga kalimtarë të rastit janë denoncuar 80 raste të fëmijëve të ndodhur në situatë rruge, të shfrytëzuar për lypje. Pas vlersimit paraprak, rastet janë referuar në institucionet bashkëpunuese.

Grafiku 9: Rastet e Referuara dhe bashkëpunimi me institucionet

Një nga funksionet themelore që ALO 116 kryen është proçesi i referimit të rasteve. Kryesisht referohen telefonata, problematika e të cilave nuk merr zgjidhje nëpërmjet telefonit. Të tilla mund të jenë psh. raste që kërkojnë ndihmë emergjente, raste abuzimi dhe dhune, raste kur kërkohet mbështetje ekonomike, ligjore etj. Gjatë vitit 2016 janë referuar **141** raste nga Tirana.

Për realizimin e referimeve , është krijuar bashkëpunim i ngushtë me institucione publike dhe organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Krahasuar me vitet e kaluara identifikohet një bashkëpunim më i gjërë me institucionet publike dhe organizatat pjesë të shoqërisë civile. Pjesa më e madhe e rasteve të trajtuara janë referuar pranë institucioneve shtetore. Çështjet për të cilat telefonuesit nga Tirana janë orientuar për të marrë një shërbim përtej këshillimit psikologjik janë nga më të ndryshmet.


Gjatë këtyre viteve tek ALO 116 janë adresuar një sërë shqetësimesh dhe problemesh që fëmijët dhe të rinjtë kanë hasur në institucionet arsimore në lidhje me shkeljen e të drejtave të tyre. Fëmijët raportojnë se ofendimet, sharjet, shkulja e veshit e në raste të caktuara ndonjë pëllëmbë, vijnë të përdoren nga mësuesit si format më të shpeshta në disiplinimin e nxënësve të arsimit parauniversitar. Më i theksuar ky fenomen paraqitet në zonat urbane, dhe kryesisht në shkollat 9-vjeçare. Raportimet e dhunës në shkollë pasi janë vlersuar dhe trajtuar nga operatorët këshillues janë referuar gjithashtu pranë ISHA, DAR Tirana dhe MAS, të cilët pasi kanë marrë sinjalizimin nga ALO 116 , kanë ngritur grup pune për të vijuar identifikimin dhe vlersimin nga afër të situatës.

Numri total i referimeve për vitin 2016 për Tiranën është 141. Pjesën më të madhe të referimeve e përbëjnë rastet e fëmijëve në situatë rruge të cilët shfrytëzohen për lypje. Këto raportime vijnë përgjithësisht nga kalimtarë të rastit të cilët raportojnë menjëherë në Linjën e Këshillimit për Fëmijë. ALO 116 bashkëpunon me të gjitha institucionet në nivel qendror dhe lokal, me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për fëmijët në situatë rruge etj. Rastet e raportuara të fëmijëve të rrugës, të referuara tek ALO 116, i referohen: kategorive të fëmijëve që lypin në qendrat kryesore urbane dhe zonave me popullim të lartë, fëmijëve që punojnë në kryqëzime rrugësh duke larë xhama makinash apo si shitës ambulantë dhe fëmijëve të cilët shihen duke lypur në lokalet e qytetit apo pranë kishave dhe vendeve me grumbullim masiv të njerëzve. Raportimet nga qytetarët e rastit të fëmijëve në Situata rruge, të shfrytëzuar për lypje janë referuar në mënyrë të menjëhershme pranë :

- ✚ Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëstë e cila koordinon burimet e ndryshme të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.
- ✚ Bashkia e Tiranës Sektori i Shërbimit Social, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Perfshirjes Sociale. Kjo strukturë e bashkisë koordinon “Skuadrat e Terrenit” të ngritura posaçërisht për të identifikuar dhe vlerësuar rastet e fëmijëve të rrugës në qytetin e Tiranës.
- ✚ Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashkitë përkatëse – të cilat kanë përgjegjësinë për identifikimin e rastit, menaxhimin dhe ndjekjen e tij derisa fëmija të mos jetë më në rrugë dhe të ketë dalë nga situatë e rrezikut të jetës dhe mirëqënies.
- ✚ Policia e Shtetit, e cila zakonisht mbahet në kontakt gjatë orëve të natës dhe gjatë orarave të ditës të pa mbuluara me shërbime nga strukturat e ngritura
- ✚ Organizatat jo fitimprurëse të cilat punojnë dhe ofrojnë shërbime për fëmijët në situatë rruge. Pjesa më e madhe e rasteve referohen tek organizata ARSIS, tek e cila ALO 116 referon gjatë 24 orëve dhe fundjavave.

Fëmijët në situatë rruge raportohen në orare të ndryshme, nga orët e para të ditës deri në mesnatë. Vihet re një shtim i numrit të fëmijëve në rrugë në oraret që nuk mbulohen me shërbime nga institucionet shtetërore dhe organizatat e jofitimprurëse që punojnë me fëmijët në situatë rruge.

ALO 116 111 ka bashkëpunuar ngushtë gjithashtu me NJMF-të e Tiranës për raportimin e raste të dhunës, fëmijëve të shfrytëzuar për lypje, familje me nevoja bazë, nevojë për ndihmë ekonomike etj. Ndërkohë ALO 116 ka kontaktuar në raste të caktuara edhe punonjë të shërbimit psiko-social të shkollave 9-vjeçare për të asistuar një fëmijë i cili ka hasur një problematikë të caktuar në shkollë në marrëdhënie me shokët/shoqet, mësuesit, shqetësime lidhur me performancën e tyre në shkollën etj.



ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës i cili ofron:

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

Me 19 tetor 2012, ALO 116 u bë anëtare me të drejta të plota e Linjës Ndërkombëtare të Këshillimit për Fëmijë (CHI) si një mundësi për të sjellë zërin e fëmijëve shqiptarë sëbashku me zërin e fëmijëve nga Europa dhe bota.

ALO 116 mbështetet dhe financohet nga :



dhe të gjitha kompanitë e telefonisë në Shqipëri:

